

## **Vleresimi I ndikimit Paraprak te Mjedisit**

Rehabilitim I tokes duke hequr zhavorret nga toka dhe duke e kthyer ate ne toke pjellore per mbjelljen e pemeve

Shtojca II pika 1) Bujqesia, silvikultura dhe akuakultura

a) Projekte per perdorimin e tokes rurale.

ME VENDODHJE:

Fshati : Lagjia e Re, Komuna Ndroq, Tirane

Zyrat qendrore te shoqerise: Durres, RRashbull Rromant

Kerkues:

Subjekti "KURTI SHPK"

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:

GBA studio



# **Vleresimi I ndikimit Paraprak te Mjedisit**

Rehabilitim I tokes duke hequr zhavorret nga toka dhe duke e kthyer ate ne toke pjellore per mbjelljen e pemeve

Shtojca II pika 1)Bujqesia,silvikultura dhe akuakultura

a)Projekte per perdorimin e tokes rurale.

ME VENDODHJE:

Fshati : Lagjia e Re,Komuna Ndroq,Tirane

Zyrat qendrore te shoqerise: Durres,RRashbull Rromanat

Kerkues:

Subjekti “KURTI SHPK”

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:

**GBA studio**

Tirane,2016

# TABELA PERMBLEDHESE

<b>1 TE PERGJITHSHME .....</b>	<b>3</b>
1.1. HYRJE .....	3
<b>2 PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL.....</b>	<b>5</b>
2.1. TE PERGJITHSHME .....	5
2.2. LEGJISLACIONI .....	8
2.3. PERMBLEDHJE E KUADRIT LIGJOR .....	9
<b>3 PERSHKRIM I PROJEKTIT .....</b>	<b>12</b>
3.1. QELIMI I PROJEKTIT .....	12
3.2. TE DHENA TEKNIKE TE AKTIVITETIT .....	12
3.3. VENDODHJA E AKTIVITETIT .....	12
3.4. PËRSHKRIMI I PROCESVEVE TEKNOLOGJIKE TË PROJEKTIT .....	14
3.5. LLOJI, VOLUMI, KONSUMI DHE PRODHIMI I LËNDËVE TË PARA .....	15
3.6. INFORMACION PËR SHKARKIMET NË MJEDIS. ....	15
3.7. CILËSIA E AJRIT DHE UJËRAVE SIPËRFAQËSORE NË ZONËN E ZBATIMIT TE PROJEKTIT.....	16
<b>4 PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT .....</b>	<b>26</b>
4.1. RAJONI I TIRANES .....	26
4.2. MJEDISI FIZIK .....	26
4.3. TENDENCAT DEMOGRAFIKE .....	27
4.4. EKOLOGJIA .....	27
4.5. GJEOLOGJIA DHE HIDROGJEOLOGJIA.....	27
4.6. RREZIQET NATYRORE .....	28
4.7. AKTIVITETE EKONOMIKE DHE SOCIALE .....	29
4.8. KLIMA .....	29
4.9. SIZMICITETI .....	30
4.10. GJEOLOGJIA DHE DHERAT .....	30
4.11. HIDROLOGJIA, UJRAT SIPERFAQESORE DHE NENTOKESORE .....	30
<b>5 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE RENDESISHME NE MJEDIS .....</b>	<b>31</b>
<b>5.1. NDIKIME TE RENDESISHME GJATE NDERTIMIT .....</b>	<b>31</b>
5.1.1. Shkarkime ne uje .....	31
5.1.2. Emetimet ne ajer .....	31
5.1.3. Zhurmat dhe vibrimet .....	32
5.1.4. Ndikimi ne toke .....	32
5.1.5. Ndikimi ne flore/faune .....	32
5.1.6. Mbetjet e prodhuara .....	32
<b>5.2. NDIKIME TE RENDESISHME GJATE FUNKSIONIMIT .....</b>	<b>33</b>
5.2.1. Shkarkime ne uje .....	33
5.2.2. Emetimet ne ajer .....	33
5.2.3. Zhurmat dhe vibrimet .....	33
5.2.4. Mbetjet e prodhuara .....	33
<b>6 MASAT KRYESORE LEHTESUESE .....</b>	<b>34</b>
<b>7 PROGRAMI MONITORIMIT .....</b>	<b>35</b>
<b>8 REKOMANDIME .....</b>	<b>36</b>

# 1. Te pergjithshme

## 1.1 HYRJE

Shoqëria “**KURTI SHPK**”, me zyra qendrore ne Durres,Rrashbull Rromanat kërkon te marre leje mjedisore per perdorimin e tokes qe ndodhet ne zonen e Ndroqit, Komuna Ndroq.Lagjia e RE ku do te rehabilitoj token per heqjen e zhavorrit qe ndodhet ne te duke e kthyer ne nje toke bujqesore per gjelberim kryesisht mbjellje pemesh.

Ky raport VNM-je siguron një vlerësim të ndikimeve bazë potenciale të mjedisit mbi projekt dhe hedh dritë mbi masat që duhen marrë për të parandaluar, minimizuar, zbutur apo kompensuar një ndikim mjedisor të pafavorshëm dhe për të përmirësuar shformimet e mundshme mjedisore, si edhe mbi menaxhimin e mjedisit dhe planet monitoruese dhe përcakton kërkesën e raportimit dhe kuadrot kohore në lidhje me to.

### ***Qëllimi i studimit është:***

- Të japë një gjendje sa më reale, nga pikëpamja e ndikimit në mjedis, dhe të çdo elementi tjetër të natyrës dhe njeriut;
- Analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore, si dhe dhënien e masave zbutëse për reduktimin e ndikimeve negative.
- Të japë një gjendje sa më reale, nga pikëpamja e ndikimit të kësaj vepre mbi mjedisin human;
- Analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisorë dhe dhënien e masave zbutëse për reduktimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit, gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti;
- Krijimin e mjedisëve te peshtatshme ekologjike pas rehabilitimit;

## **2 INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR**

### **2.1 Pershkrim te qellimit dhe objektivave te VNM**

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces ne vazhdimesi i aktivitetit dhe siguron se ndikimet mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet.

#### **Qellimi i VNM- se**

Qellimi i hartimit te raportit te VNM-se eshte percaktimi i efekteve negative dhe pozitive te aktivitetit dhe masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis si rezultat i zhvillimit te projektit te shfrytezimit te argjiles ne Zonen minerare Maliq nr.308. VNM nuk do te mbuloj cdo aspekt te nje efekti mjedisor te projektit, me te njejtin nivel detajesh. Theksi do te vihet ne ndikimet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjetër eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteteve te propozuara.

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te ndikimeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit ne mjedis te aktivitetit te hapjes, pergatitjes se karrieres dhe shrytezimit me punime siperfaqesore te gurit gelqeror, mbi mjedisin human.
- Analizes se faktoreve pozitive e negative mjedisore dhe te masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne mjedis te projektit.

#### **Objektivat e VNM**

Objektivat e hartimit te VNM- se konsistojne ne evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve ne mjedis dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrueshem te mjedisit, gjate kryerjes se aktivitetit minerar deri ne perfundim te aktivitetit dhe rehabilitimin e hapesires se shfrytezuar dhe te prekur nga aktiviteti, per nje mjedis te qendrueshem ne vitet pas ardhese.

Me kete studim informojme organet vendim-marres, mbi ndikimet ne mjedis dhe perfitimet e projektit te propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

#### **2.2 Objektivat e tjera te studimit te paraqitur jane.**

- Permiresimet mjedisore te zones ku zbatohet projekti dhe rreth saj.
- Perdorimin e burimeve natyrore ne menyren te qendrueshme ku respektohen dhe kerkesat e komunitetit te zones per rreth.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale

negative te projektit te zbatuar

-Lehteson informimin e organeve vendim-marrese, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

-Mbrojtjen e shendetit te njeriut.

-Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit.

-Ruan dhe mbron burimet natyrore, peziashet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve.

-Permireson aspektet sociale te projektit.

### **2.3 Pershkrim i permbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional qe lidhet me projektin**

-Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”I ndryshuar.

-VKM-229-DATE-23.04.2014-Miratimine-rregullave-per-transferimin-e-mbetjeve-jo-te-rrezikshme

- Ligjit ``Per Lejet e Mjedisit`` Nr.10448 date 14.07.2011,I ndryshuar,

Ligjit Nr 60/ 2014 date 19.06.2014

-VKM Nr 13 date 04.01.2014 ``Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afatave per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis

-VKM nr.575,date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”

-Ligji 12.2015 date 26.02.2015 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440 datë 7.7.2011”Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”

-VKM nr. 686 datë 29.7.2015, Për miratimin e rregullave të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore

-VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja.

-VKM. Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”

-Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”

-Ligj Nr 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”. -Udhëzim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »

-Udhëzim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’

-Urdhri e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”

-Udhëzimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”

-Udhëzim Nr 3, datë 17.05.2006 “Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret”

-VKM. Nr 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”.

-Ligji Nr 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.

-Ligji Nr 9115, datë 27.02.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.

- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”
- Ligji Nr 8906, datë 06.02.2002 “Për zonat e mbrojtura”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
- Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave

**Autoret e hartimit te raportit Paraprak te VNM-se**

**Raporti paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis u pergatit nga  
“Green Business Albania” shpk, me autore:**

Ing. Mjedisi Dhurata Lumani

Ekspert Mjedisi Elgerti Bixha

### 3 PERSHKRIM I PROJEKTIT

#### 3.1. Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit është rehabilitimi I tokës me zhavorr dhe kthimi I saj në tokë bujqësore pjellore e cila do shërbejë me vone si tokë bujqësore ose sivikulture për mbjelljen e pemeve. Rehabilitimi I tokës do të kryhet në përputhje me të gjitha rregullat e lejuara dhe ligjet e mjedisit.

#### 3.2. Te dhëna teknike të aktivitetit

Subjekti “Kurti ” Sh.p.k i regjistruar pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit, me Numer Identifikimi të Personit të Tatueshëm: K51801503I, me seli në Durres Rrashbull Rromanat dhe administrator Z. Lutfi Kurti, do të rehabilitojë tokën që ndodhet në komunën Ndroq lagjia e Re e cila aktualisht është e mbushur me zhavorr dhe pemë. Për arsye se sasia e zhavorrit nuk i lejon pëmet të ritën subjekti ka marrë për siper të largojë sasinë e zhavorrit që ndodhet në tokë të përpunojë tokën derisa të kthehet në një tokë të përshtatshme bujqësore për mbjelljen e pemeve.

Subjekti, për realizimin e projektit të tij do të paiset me të gjitha miratimet përkatëse të lejeve të nevojshme për nderhyrjen në këtë tokë.

**Emri i Tregtar** “KURTI ”Shpk

<b>Sipërfaqja e zënë nga Zhavorri</b>	864 m <sup>2</sup>
<b>Sipërfaqja në pronësi</b>	3000m <sup>2</sup>
<b>Veprimtaria</b>	Rehabilitim I tokës nga zhavorri
<b>Statusi shoqërisë</b>	Aktiv
<b>Vendodhja e Aktivitetit</b>	Fshati Ndroq, adresa e selisë Rromanat, rrashbull, Durres.



### 3.3. Vendodhja e Tokes qe do te rehabilitohet sipas Gaus Kruge

Projekti ne vleresim ndodhet prane rruges Tirane-Durres ne Fshati : Lagjia e Re,Komuna Ndroq.



N	E
41 16 1.20	19 39 1.77

### 3.4. Përshkrimi i proceseve teknologjike të projektit

Proceset teknologjike ne kete projekt nuk kane ndojnje zhvillim shum te madh ndaj po I bejme nje permbledhje ne menyre te shkurtuar. Si fillim do ndodh shkulja e pemeve qe ndodhen ne toke me pas me ane te eskavatoreve do hiqet sasia e zhavorrit qe ndodhet aty.Ky zhavor do transportohet me ane te saurelave me mbulesa ne menyre qe te shmangi sa me shum tymrat dhe pluhurat te mos perhapen ne zonen perreth.Subjekti do ta coje sasine e zhavorrit ne nje vend te pershtatshem dhe ne kuader te gjithe sistemit ligjor.Me pas do filloj rehabilitimi I tokes dhe kthimi I saj ne nje toke te pershtatshme bujqesore.

### 3.5. Lloji, volumi, konsumi dhe prodhimi i lëndëve të para

Lendet e para te perdorura do te jene kryesisht uji qe do te sherbeje per sperkatjen e vazhdueshme te tokes ne menyre qe te mos perhapen tymrat ne ambjentin perreth,energjia elektrike qe do te sherbeje per ndricimin e zones aty dhe per venien ne pune te makinerive dhe nafta qe do te sherbeje per transportin e saurelave.

Shkarkimet e ujerave, do te lidhen me sistemin e kanalizimeve te zones, ku pas ndryshimeve te viteve te fundit, duhet te ndertohet nje rrjet i ri me kapacitete me te medha. Studimet duhet te hartohen per nje periudhe afatmesem dhe afatgjate.

### **3.6. Pershkrimi I mbuleses bimore**

Siperfaqja eshte toke bujqesore e llojit are, me bimesi barishtore dhe relief te sheshte. Nuk karakterizohet nga flore dhe faune me interes per komunitetin dhe institucionet e mbrojtjes se mjedisit.

### **3.7. Informacion për shkarkimet në mjedis.**

Shkarkimet ne mjedis gjate fazes se punes do te jene kryesisht pluhurat nga punimet e Heqjes se sasise se zhavorrit, si dhe zhurmat ne mjediset e punes nga makinerite e punimeve. Ky efekt mund te transmetohet edhe ne mjediset e zones perreth nese nuk kryhet larja dhe pastrimi i mjeteve para daljes se tyre nga kantieri dhe lagia e siperfaqeve te pa shtruara gjate sezonit te thate. Keto ndikime do te jene te perkohshme dhe nuk do te kene veti akumuluese ne mjedisin e zones. Mbetjet e ngurta nga fazafillestare do te jene Sasi zhavorri. Persa i perkete sasise se dheut qe do te hiqet nga sheshi , ajo eshte relativisht e madhe. Ky proces eshte ende nje problem serioz per zhvilluesit sot, ku ende nuk eshte percaktuar perfundimisht menyra e menaxhimit te tij. Aktualisht, subjektet private e transportojne ate per nje rruge te gjate deri ne periferi te qytetit, duke e shkarkuar ne zona te percaktuara nga komunat. Transportimi i ketij materiali perben nje shkak per rritjen e ndotjes ne qytet dhe kosto te larta per investitorin dhe bleresit e ambjenteve te reja.

### **3.8. Cilësia e ajrit dhe ujërave sipërfaqësore në zonën e zbatimit të projektit**

Per zonen e Tiranes jane publikuar dis ate dhena te monitorimit te cilesise se mjedisit nga raporti vjetor i monitorimit te mjedisit te Ministrise se Mjedisit. Nuk jane kryer matje te elementeve te mjedisit te zones prane sheshit te zhvillimit nga Ministria e Mjedisit, pasi kjo zone nuk vleresohet nga me problematiket me perqendrim te larte te elementeve ndotes te mjedisit.

Cilesia e ajrit ne kete zone vleresohet relativisht e mire dhe me parametra brenda normave shqiptare te lejuara me ligj. Duke qene nje zone e pa zhvilluar mire dhe pa aktivitete ndertuese, nuk ka aktivitete me shkarkime te konsiderueshme ne mjedis. Persa i perkete ujerave siperfaqesore, ne kete zone nuk ka informacione per ndotje tej normave te lejuara. Ky informacion nuk perfshine ndotjen e Lumenjve si Lumi Tiranes dhe Lumi i Lanes. Ujerat e ketyre lumenjve vleresohen te jene te ndotura per shkak te shkarkimeve te ujerave te zeza,

ujerave te aktivitetit te zonave tregtare e industriale dhe te mbetjeve urbane te hedhura ne to. Lumi i Lanes eshte nga lumenjte me te ndotur ne rajonin e Tiranes, por edhe ne shkalle vendi. Ndotja kryesore e ketij lumi vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotur urbane te pa trajtuara, kjo sjell per pasoje ndotjen bakteriale te tij, si dhe ndotjen me elemente te tjere te cilet ndodhen ne detergjente te ndryshem dhe aktivitete te tjera te qytetit si fosfori (P), Azoti (N), etj. me poshte paraqiten disa rezultate te matjeve te fatoreve te cilet tregojne cilesine e ujit te lumenjve:

Matjet jane kryer per tre pika te lumit Tirana perkatesisht T1, T2, T3. Nga te dhenat monitoruese te Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave per cilesine e lumenjve ne vend, me problematiket paraqiten lumi i Lanes dhe ai i Tiranes, te cilet kalojne permes qytetit te Tiranes dhe rrethinave pothuajse te mbipopulluara.

Permbajtja NBO, NKO dhe NH<sub>4</sub>, paraqitet ne nivele te larta ne lumin e Tiranes ne stacionet

T2 dhe T3 dhe me e larta ne lumin Lana ne stacionet L2 dhe L3.

### **Cilësia e ajrit në qytetin e Tiranës per vitin 2012**

Qyteti i Tiranës sipas të dhënave të monitorimit të certifikuar nga OBSH, qyteti i Tiranës ka për here të parë ajër të cilësisë brënda normës së BE-së. Ndotja e lartë në parametrin PM (pjesëza të ngurta) lidhej me cilësinë e keqe të rrugëve, me trafikun e bllokuar rrugor, me aktivitetin e ndërtimit dhe pjesërisht me ngrohjen e banesave. Ndotësit e krijuar nga trafiku përfshijnë hidrokarburet, oksidet e azotit, lëndën e grimtuar dhe monoksidin e karbonit. Praktikisht Tirana nuk ka tashmë burime të rëndësishme industriale të ndotjes së ajrit, si dytre dekada më pare

### **Sfondi i monitorimit te cilesise se ajrit.**

Qyteti i Tiranës ka monitoruar cilësinë e ajrit që në mesin e viteve 1970. Monitorimi fillimisht

është fokusuar te dioksidi i squfurit dhe bloza, në përgjigje të ligjit të atëhershëm të mbrojtjes së mjedisit. Pas viteve 2000 vëmëndja e monitorimit të cilësisë së ajrit u cvendos për t'ju përgjigjur ndryshimeve të burimeve predominues të ndotjes. Fillimisht burimet kryesore ishin industria dhe djegia e qymyrit dhe e druve, por këta ja lënë vëndin automjeteve.

Qyteti tashmë mund të konsiderohet një zone problematike për përmbajtjen në ajrin e vet të

grimcave të imëta të dioksidit të azotit, dhe monitorimi i cilësisë së ajrit po fokusohet në 'ta. Monitorohen edhe një numër ndotësish të tjerë, për të kontrolluar ecurinë e tyre ndonëse janë të rëndësishë sekondare.

Programi i monitorimit në qytet është në përmirësim e sipër, për efekt të dy stacioneve automatike të sjella në maj të vitit 2010 nga qeveria gjermane / OBSH për ISHP, dhe ngritjen

e aftësive teknike të këtij institucioni.

### **Monitorimi i cilësisë së ajrit në vitin 2012**

Monitorimi i cilësisë së ajrit në vitin 2012 është kryer me dy stacione automatike me funksionim të vazhdueshëm dhe me dy fushata dy javore secila me tuba difuzë.

Raporti Vjetor i Cilesisë së Ajrit, Tirana 2012 - ISHP® **Stacionet automatike**

Për një përmbledhje të monitorimit të ajrit në qytet janë duke u përdorur dy stacione me pune të pandërprerë. Të dhënat e ketyre stacioneve janë procesuar e korigjuar sipas standarteve teknik përkatës,

me asistencën e ekspertëve të projektit CEMSA të delegacionit të KE-së në Tiranë.

Kjo përshkruhet dhe diskutohet më tej ne seksionet 3.2 dhe 3.6.

Dy pikat e monitorimit të vazhduar janë të përfshira në rrjetin e monitorimit të ajrit për Tiranën, prej ISHP dhe laboratorit të cilësisë së ajrit.

Monitorimi i cilësisë së ajrit në 2012 duke perdorur stacione me punë të vazhduar.



**Figura, tregon vendosjen e të gjitha pikave të monitorimit në qytetin e Tiranës  
Rezultatet e cilesisë së ajrit dhe Variacionet stinore**

Ka tendenca stinore të përgjithshme në cilësinë e ajrit që lidhen me kushtet e motit. Cilësia e ajrit në dimër është më e rënduar se në stinën e verës e të pranverës. Kjo për arsyet e mëposhtme:

**Dimri:** Në dimër ndotjes së shkarkuar nga makinat i shtohet edhe ndotja e shkarkuar nga djegia e lëndëve djegëse për ngrohje. Kjo ndotje në përgjithësi mbetet mbi qytet, kur ajri në lartësi rreth 80-100m është më i ngrohtë se ajri në nivelin e tokës. Kjo gjë shkakton formimin e një fare 'kapaku' që nuk lejon shpërhapjen e ndotjes dhe fenomeni njihet si inversion temperature.

Këto kushte janë vecanërisht dominuese në ditët e ftohta e pa ere, shpesh pas një natë pa re dhe kur mëngjezi është me ngricë. Reshjet e shiut përgjithësisht ulin përmbajtjen e ndotësve

në ajër, vecanërisht atë të grimcave të imta.

**Vera:** Në verë drita e diellit reagon me ndotjen e shkarkuar prej makinave. Ky veprim rezulton në rritjen e përmbajtjes së ozonit në nivelin e sipërfaqes së tokës.

**Monoksidi i karbonit (CO)**

Monoksidi i karbonit (CO) është një gaz pa shije, ngjyrë dhe ere. Burimi i tij kryesor në ajrin mjedisor është transporti rrugor. Por edhe proceset e djegies për ngrohje nga popullata janë një burim i konsiderueshëm.

Në qytetin e Tiranës burimi kryesor është djegia jo e plotë e karburanteve në automjetet rrugore dhe përqëndrimet më të larta hasen pranë rrugëve.


Raporti Vjetor i Cilësisë së Ajrit, Tirana 2012 - ISHP® Përqëndrimet e monoksidit të karbonit

determinohen prej masës së shkarkimeve dhe dispersionit. Ato janë më të larta në muajt e dimrit kur dispersioni i atmosferës është më i dobët. CO në atmosferë oksidohet deri në

dioksid karboni (CO<sub>2</sub>).

Monitorimi për CO në qytetin e Tiranës ka filluar në vitin 2010. Që atëhere përqëndrimet rezultojnë të ulët dhe në asnjë rast nuk është kapërcyer shifra e objektivit të cilësisë së ajrit të vëndeve të KE.

**Grafiku tregon përqëndrimet mesatare mujore të CO që janë të ulta në të dy pikat gjatë**



### Dioksidi i azotit (NO<sub>2</sub>)

Dyoksidi i azotit është me shumë një ndotës sekondar, i formuar prej oksidimit të oksidit nitror NO.

Në qytetin e Tiranës burimi primar i oksidit nitror janë makinat, ndonëse po rritet edhe kontributi relativ nga banesat (ngrohja dhe ftohja). Ndikimet mbi shëndet të dyoksidit të azotit diskutohen në Apendiksin B. Si edhe në rastin e monoksidit të karbonit, përqëndrimet

kane prirje të jenë me të larta gjatë muajve të dimrit, kur dispersioni është me i dobët.


Në qytetin e Tiranës dyoksidi i azotit është monitoruar duke përdorur dy stacionet automatik

me punë të vazhdueshme gjatë vjetore dhe dhjetë pika ku janë montuar dy here nga dy javë

(janar dhe qershor) tubat difuze. Tabela dhe grafiku japin rezultatet mesatare vjetore në të gjitha pikat e monitorimit. Grafiku jep ecurinë mujore të NO<sub>2</sub> në dy stacionet automatike të Tiranës.

Stacionet automatike japin të dhëna orare dhe ditore, ndërsa tubat difuze japin të dhëna mesatare dy javore. Verëhet qartë që përmbajtja e dyoksidit të azotit në qendrën e qytetit dhe në kryqezimet e trafikut tashmë kapërcen vlerën kufi të KE (40 µg/m<sup>3</sup>), ndërsa në asnjë

rast nuk është kapur kapërcim i vlerës kufi orare të KE (200 µg/m<sup>3</sup>).



### Dyoksidi i squfurit (SO2)

Dyoksidi i squfurit (SO2) eshte nje gaz pa ngjyre , i cili ne perqendrimet e larte ka shije dhe ere. Ai mund te formohet prej aktivitetit te njeriut, por haset edhe natyralisht. Djegia e naftes


dhe qymyrit, si edhe e gazit , kur keta parmbajne squfur mund te konsiderohet si burimi kryesor i formimit te tij.

Edhe me keto kontribute, mund te thuhet me siguri qe permbajtja e tij ne ajrin e qytetit te Tiranes eshte me e ulet se ajo e lejuar prej legjislacionit te KE.

Eshte ky nje fenomen mbare european, qe lidhet se pari me uljen e permbajtjes se tij ne lendet djegese me baze naftes, per efekt te teknologjive te heqjes se squfurit ne keto lende

tre dekadat e fundit. Naftat shqiptare permbajne perqindje te larta squfuri (3-6 perqind), si edhe

nen produktet e tyre, por ne vendin tone perdoren per rreth 2/3 lende djegese importi me permbajtje squfuri nen ate te naftave tona. Kjo ben qe SO2 i formuar te jete ne sasi relativisht te vogla.



**Grafiku tregon permbajtjet mesatare vjetore te SO2 ne ajer ne te gjitha pikat e monitoruara ne Tiranë (dy pikat me stacione automatike dhe katër pika me tuba**


**difuze). Në asnjë rast nuk kapërcehet përqendrimi i lejuar në vendet e KE.  
Ozoni (O3)**

Ozoni (O3) është një gaz mjaft reaktiv, që ekziston në pjesën e poshtme të atmosferës (nivelet e tokës) por edhe në troposferë. Ai nuk shkarkohet direkt nga njeriu, por formohet nga reaksionet kimike mes ndotesish të tjera, shpesh të inicuar prej dritës së fortë të diellit. Me që është një ndotesë sekondare, masat për ta menaxhuar ozonin në nivel lokal kanë provuar se kanë efektivitet të ulët.

Në zonat urbane oksidi nitror (NO) mund të reagojë me ozonin për të formuar dyoksid azoti (NO2). Kjo mund të pakesojë përqendrimet e ozonit në nivelet e tokës por të rrisë ato të dyoksidit të azotit. Në zonat rurale kjo nuk ka si të ndodhë në të njëjtën masë dhe nivelet e ozonit janë gjetur të jenë më të larta në zonat rurale se në ato urbane. Përqendrimet e larta të

ozonit mund të demtojnë funksionin e mushkerive dhe të shkaktojnë irritim të traktit respirator. Azmatiket janë vecanerisht të ndjeshëm ndaj niveleve të tij të larta. Efektet shëndetsore të ekspozimit ndaj ozonit diskutohen më poshtë në Apendiks B.

Ozoni është monitoruar me dy stacionet automatike gjatë vitit 2012 në qendër të qytetit (poliklinika qendrore) dhe në zonën e ISHP. Po ashtu është matur edhe me tuba difuze, në 10 pika të tjera, analogjikisht si rasti i dyoksidit të azotit.



**Grafikun tregon të gjitha pikat e monitorimit, të ndara në periudhën dimër/verë.  
Grimcat e imta (PM10 dhe PM2.5)**

PM10 është lende e grimtuar e imet, me diametër grimcash më të vogël se 10 mikron. Ajo ka dy burime kryesore, primare (e shkarkuar direkt) dhe sekondare (e ndryshuar kimikisht ose fizikisht në atmosferë). Ndërsa PM2.5 është lenda e grimtuar shumë e imet, me diametër grimcash më të vogël se 2.5 mikron.

Keto lloj grimcash te ajrit konsiderohen aktualisht prej Organizates Boterore te Shendetsise

(OBSH) si ndotesit me te rrezikshem urban per shendetin e njeriut

### **Perfundime**

Stacioni i Tiranes qender ka nje ulje te shprehur te PM 10 e te PM 2.5 ne ajer ne krahasim me

vitin 2011, ne masen 20-30 perqind. Kjo si rezultat i 'hapjes' se qendres per trafik normal, pas dt. 15.11.2011. Sidoqofte ecuria e kesaj ulje duhet ndjekur ne vijimesi, per te sqaruar qendrueshmerine e tendences (graf. 4.1).

Verehet gjithashtu edhe nje fenomen karakteristik lidhur me permbajtjen e grimcave te imta

ne ajrin urban te Tiranes. Permbajtja e grimcave, PM 2.5 dhe PM 1 eshte praktikisht e njellojte ne qender te qytetit dhe ne periferi te tij. Kjo thekson gravitetin e problemit te grimcave te imta ne ajrin urban, dhe vendos studjuesit e vendimmarresit para detyrash jo te

lehta per te luftuar ndotjen e ajrit ne te ardhmen.

Edhe pse ka nje permiresim te permbajtjes se grimcave ne ajer krahasuar me vitin 2011, Tirana vazhdon te mbetet nje qytet me ajer te rrezikshem per jeten ne qendren e saj.

### *Indeksi*

*shendetsor i cilesise se ajrit* (AQHI – formula 4.4), mjaft i njohur tani ne Ameriken Veriore (Kanada), ka gjithashtu nje permiresim te mases rreth 10 perqind, por qendron perseri prane atij qe konsiderohet kufi i ajrit te rrezikshem per jetesen e popullates.

### **Zhurmat**

Nuk ka as monitorim te nivelit te zhurmave ne zonen ne vlersim, monitorimet jane kryer per disa pika te qytetit te Tiranes duke qene se ky qytet ka ne disa pika te tij trafik te renduar dhe zhvillime dinamike ne fushen e ndertimit te objekteve te banimit. Ndonese kjo zone eshte me me pak trafik dhe rruge te renduara nga trafiku, eshte nje zone e prekur ndjeshem nga zhvillimet si ne fushen e ndertimit te objekteve te banimit ashtu edhe ne zhvillimin industrial e tregtar, kryesisht zona pergjate autostrades "Tirane-Durres". Zhurmat jane nje problem i zakonshem urban dhe me problematike ne segmentet me me shume qarkullim dhe trafik te renduar.

Nga monitorimi i kryer ne qytetin e Tiranes rezulton se zhurmat jane mbi nivelin e lejuar kryesisht gjate oreve te nates, ku edhe limiti eshte me i ulet se gjate dites

Vlerat vjetore te zhurmave jane paraqitur si me poshte:

Tabele 1: Vlerat mesatare te zhurmave per ditën dhe naten per vitin 2008

**Tirana** 70.80 dB 61.80dB

Zhurmat ne keto zona kryesisht burojne nga: automjetet, ndertimi, aktivitetet tregtare dhe trafiku ajror.

**Burimi i informacionit: Bashkia Tirane**



## **4 PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT**

### **4.1. Rajoni i Tiranës**

Qyteti i Tiranës shtrihet në një luginë rreth 40 km larg detit dhe në një lartësi mbi 100 metrash. Ka një klimë mesdhetare me verë të ngrohtë dhe të nxehtë e me një sasi reshjesh 1200 mm gjatë dimrave të butë. Temperatura vjetore mesatare është 16°C në muajin më të ftohtë, janarin, me temperaturë 6°C dhe korrikun si periudha më e ngrohtë, me një temperaturë mesatare 24°C. Afërsia e maleve të lartë në lindje të qytetit bën që të dominojnë

erërat me drejtim veri-perëndim dhe jug-perëndim.

Bashkia e Tiranës zë një hapësirë prej 41.8 km<sup>2</sup> dhe është thajse totalisht e urbanizuar. Rrethi i Tiranës zë një hapësirë prej 1,288 km<sup>2</sup> dhe përfshin të gjitha komunat përreth Bashkisë së Tiranës, duke u kufizuar me Komunat e Dajtit, Farkës, Vaqarrit, Kasharit, Bërçullës dhe Paskuqanit, dhe ndan një kufi të shkurtër me Bashkinë e Kamzës.

Për numrin e popullsisë në 2008, ka vetëm vlerësim dhe ka shumë mundësi të jetë me pak se

në realitet, pasi shumë banorë nuk janë të regjistruar në këto zona, por mund të rezultojnë ende si banorë të qyteteve apo fshatrave nga kanë ardhur. Informacioni demografik, në tërësi, është i dobët.

### **4.2. Mjedisi Fizik**

Qyteti i Tiranës zë vend në një rrafshinë midis Lumit Lana dhe Lumit Tirana. Kjo rrafshinë bën pjesë në një rrafshinë më të madhe ku ndodhen Kruja dhe Lezha, ujërat e të cilave rrjedhin drejt veriperëndimit. Mbi rrafshinë ngrihet 1600 metra Mali i Dajtit, i cili dominon horizontin në perëndim të qytetit. Kodrat më të ulëta të Saukut, Kërrabës dhe Vaqarrit, që ngrihen 300 metra, rrethojnë luginën, përkatësisht në perëndim, lindje dhe jug. Kodrat më të

ulëta formojnë vargje kodrash deri në bregdetin e Adriatikut me dy korridore nga Durrësi, gjë që lejon me lehtësi komunikimin me bregdetin dhe lejon gjithashtu mbërritjen e rrymave

ajrore detare deri në Tiranë.

Me zgjerimin e qytetit, zona midis lumenjve tashmë është urbanizuar plotësisht dhe zhvillimi

është shtrirë në kodrat përreth qytetit. Korridori verior drejt bregdetit, i cili lidh Tiranën me

Durrësin ka njohur gjithashtu zhvillim të madh me një përzierje veprimtarish komerciale, të

industrisë së lehtë e rezidenciale. Bashkia e Tiranës vlerëson se tani zona urbane zë rreth 40 për qind të luginës, ndërsa ekspansioni urban po kap edhe kodrat përreth. Ndërtimet në perëndim, në Malin e Dajtit janë një problem serioz, ku shpyllëzimi dhe urbanizimi, përveç përkeqësimit estetik të zonës, pritet të rrisë nivelin e rrëshqitjeve dhe mund të paraqesë rreziqe serioze përmbajtjeje për qytetin.

### **4.3. Tendencat Demografike**

Qarku i Tiranës kishte një popullsi prej 766 mijë banorësh më 2013 me rritje 26.1 për qind në krahasim me vitin 2001 kur kishte 597 mijë banorë. Rritja mesatare vjetore është 2.1 për qind.

Popullata urbane e Tiranës është rritur nga 380 mijë në 559 mijë banorë, me rritje totale prej 42 për qind dhe rritje mesatare vjetore prej 3.1 për qind. Popullata rurale e Tiranës ka rënë me 1.1 për qind mes viteve 2001 dhe 2013 nga 217 mijë në 213 mijë.

Norma e urbanizimit të Tiranës është rritur nga 64 në 72 për qind. Tirana ka një sipërfaqe prej 1652 kilometrash katrorë dhe densitet popullate prej 464 banorë për kilometër katrorë.

### **4.4. Ekologjia**

Edhe urbanizimi i planifikuar dhe i mirë menaxhuar mund të reduktojë ndikimin e florës mbi faunën lokale. Rajoni i Tiranës ka një gamë të gjerë flore dhe faune; ekzistojnë rreth 1600 specie bimësh me përqindje të lartë në raport me sipërfaqen e rajonit. Flora e zonës është e pasur me pemë të tilla si lisi, ahu, pemë halore, si dhe pemë frutore si hurma, kumbulla, shega, mana, kajsia e rrushi e shumë bimë të tjera dekorative.

Përveç shkarjes së tokës, shkatërrimi i pyjeve nuk do të thotë vetëm humbje pemësh, por edhe humbje e diversitetit si pasojë e humbjes së zonave të habitatit dhe të zonave ushqyese.

### **4.5. Gjeologjia dhe hidrogeologjia**

